

Nr 192
7/12/15



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHITËTËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Nr. 9172 Prot.

Tiranë, më 27 / 11 /2015.

Drejtuar: SH.A "AEROPORTI NËNË TEREZA" ✓

TIRANË

Lënda: Emërim Eksperti.

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, për të kontrolluar dhe certifikuar llogarite vjetore, caktohen si Ekspert Kontabël të Autorizuar:

1. Aida MALOKU
2. Hazbije LEKA

Drejtoria para fillimit të punës harton me Ekspertin një projekt-marrëveshje për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave të verifikimeve, kontrolleve, raportimeve etj. për përmbushjen e misionit, orët e punës të parashikuara si dhe honorarin gjithsej.

Përveç raportit standard të auditimit, ekspertët të dorëzojnë në MZHETTS relacion shpjegues për të gjithë zërat e bilancit si dhe sugjerimet e tyre për shoqëritë në vështirësi financiare.

MINISTRI
ARBEN AHMETAJ

RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL TE REGJISTRUAR

Periudha 1 Janar - 31 Dhjetor 2015

“AEROPORTI NENE TEREZA”Sh.a.

Eksperte Kontabel te Rregjistruar

Hazbie Leka

Aida Maloku

Tirane me 22.04.2016

Permbajtja

I. RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

II. PASQYRAT FINANCIARE DERI NE 31.12.2015

- ❖ **Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci)**
- ❖ **Pasqyra e performances (pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve)**
- ❖ **Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare**
- ❖ **Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto**
- ❖ **Shenime mbi pasqyrat financiare**

III. SHENIME PER DREJTIMIN E SHOQERISE

- 1) Te dhena te Pergjithshme mbi shoqerine**
- 2) Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel**
- 3) Organizimi i Kontabilitetit**
- 4) Shenime per Pasqyrat Financiare**



“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

I. Raport i Eksperteve Kontabel te Rregjistruar
Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare te Shoqerise

“AEROPORTI NENE TEREZA” Sh.a.

Drejtuar:

- 1. Aksionerit te Vetem**
- 2. Keshillit Mbikqyres**
- 3. Drejtorit te Pergjithshem**

Te Shoqerise “ Aeroporti Nene Tereza” Sh.a.

Adresa: Rruga e Durrës, Nr. 202, Tirane

Te nderuar Zoterinj !

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare bashkelidhur te shoqerise “Aeroporti Nene Tereza” Sh.a., per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2015, qe perfshijne Pasqyren e pozicionit financiar (Bilancin), Pasqyren e performances (te ardhurave dhe shpenzimeve), Pasqyren e fluksit te mjeteve monetare dhe Pasqyren e ndryshimeve ne kapitalin neto per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te Politikave Kryesore Kontabel dhe Shenimet Shpjeguese.

Pergjegjesia e Drejtimit Per Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te Pasqyrave Financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK.) Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te Pasqyrave Financiare pa gabime materiale nga pasaktesia ose gabime, perzgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabel dhe berjen e vleresimeve te duhura kontabel te pershtatshme per shoqerine.

Pergjegjesite e Audituesit

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto Pasqyra Financiare. Ne e kryem auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA). Keto standarte kerkojne qe ne te permbushim kerkesat e etikes, te planifikojme dhe kryejme auditimin per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per sigurimin e te dhenave te auditimit per shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura jane ne gjykim te audituesve, duke perfshire vleresimin e rriskut te anomalive materiale si rezultat i gabimeve ose pasaktesive. Gjate vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesit marrin ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te Pasqyrave Financiare ne menyre qe te percaktoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat financiare, por jo per qellim te shprehjes se nje opinionimi per efektivitetin e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtatshmerise se parimeve kontabile te perdorura dhe pranueshmerine e çmuarjeve kontabel te kryera nga drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te Pasqyrave Financiare.

Ne besojme se te dhenat e auditimit qe ne kemi siguruar jane te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te bazuar opinionin tone.



"AEROPORTI NENE TEREZA" SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

Arsyet per dhenien e opinionit me rezerve jane:

- (a) Ne nuk mund te merrnim pjese gjate procesit te inventarizimit fizik te aam-ve deklaruar ne një vlerë totale 6.087.029.413, sepse kjo datë ishte para angazhimit tonë si auditues të shoqërisë, por ne jemi njohur me proceduren e kryerjes se inventareve ne fund te vitit si dhe me materialet e inventarizimit te cilat na japin pershtypjen e nje procesi te rregullt inventarizimi.
- (b) Shoqeria duhet te rakordoje me organet tatimore per te drejtat dhe detyrimet ndaj ketij institucioni, megjithese shoqeria Aeroporti "Nene Tereza" sha ne date 07.05.2015 i eshte drejtuar me shkresen nr. 88, Drejtorise Rajonale Tatimore, Tirane per rakordim detyrimesh.
- (c) Shoqeria nuk mund te konfirmoje shumen ne pozicionin financiar "Detyrime ndaj institucioneve te kredise" ne shumen 3.741.230.101 leke sepse eshte e parakorduar me shoqerine "Tirana International Airport" shpk, me Ministrine e Financave dhe Ministrine e linjes, megjithese shoqeria Aeroporti "Nene Tereza" sha i eshte drejtuar me shkrese nr.137, date 16.7.2014, lenda: Kerkese per informacion, shkrese nr. 198, date 29.12.2015 lenda: Kerkese per negociim shoqerise Tirana International Airport "Nene Tezera" shpk, pergjigja e te cilave eshte qe shoqeria TIA ka permbushur detyrimet e percaktuara ne marreveshje.

Opinion

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare te Shoqerise "Aeroporti Nene Tereza" Sha, me përjashtim të efekteve te mundshme të rregullimeve nëqoftëse do kishte te tilla, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme për tu bindur sipas çështjeve të referuara në paragrafët (a-c) më sipër, Pasqyrat Financiare japin nje pamje te vertete dhe te besueshme te gjendjes financiare te Shoqerise "Aeroporti Nene Tereza" Sh.a., me date 31 Dhjetor 2015, si dhe te rezultateve te veprimtarive te saj per ushtrimin e mbyllur, ne pajtim me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) dhe Ligjit nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Eksperte Kontabel te Regjistruar



Tirane, me 22 Prill 2016

Eksperte Kontabel te Regjistruar
AIDA MALOKU

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

II. PASQYRAT FINANCIARE DERI NE 31.12.2015

❖ AKTIVET

Nr	A K T I V E T	2015	2014
	Aktivitet Afatshkurtra		
	▶ Aktivitet monetare	16,787,512	30,344,073
	1 Banka	16,780,724	30,337,319
	2 Arka	6,788	6,754
	▶ Investime	0	0
	1 Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit		
	2 Aksionet e veta		
	3 Te tjera Financiare		
	▶ Të drejta të arkëtueshme	490,377,980	1,011,939,036
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit (kliente)	521,754,446	521,209,425
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit		
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
	4 Të tjera kërkesa të arkëtueshme	489,832,959	490,729,611
	5 Provizione për klientet	(521,209,425)	
	▶ Inventarët	84,462	119,980
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	84,462	119,980
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte		
	3 Produkte të gatshme		
	4 Mallra		
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)		
	6 AAGJM të mbajtura për shitje		
	7 Parapagime për inventar		
	▶ Shpenzime të shtyra		
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA	507,249,954	1,042,403,089
	Aktivitet Afatgjata		
	▶ Aktive financiare	0	0
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		
	6 Tituj të tjerë të huadhënies		
	▶ Aktivitet materiale	17,737,031	11,658,745
	1 Toka dhe ndërtesa	16,690,783	11,265,745
	2 Impiante dhe makineri	166,333	207,916
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje	879,915	185,084
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces		
	▶ Aktivitet biologjike		
	▶ Aktive jo materiale:	6,069,292,382	6,084,997,038
	1 Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe	6,069,251,032	6,084,945,350
	2 Emri i Mirë		
	3 Aktive jo materiale të tjera	41,350	51,688
	▶ Aktive tatimore të shtyra		
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar		
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA	6,087,029,413	6,096,655,783
	AKTIVE TOTALE	6,594,279,367	7,139,058,872

[Signature]

[Signature]

"AEROPORTI NENE TEREZA" SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

❖ DETYRIMET DHE KAPITALI

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	2015	2014
▶	Detyrime afatshkurtra:	43,160,120	48,793,080
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredisë</i>		
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit(Furnitore)</i>	1,960,716	7,164,601
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
6	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve</i>	11,199	11,206
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
8	<i>Të pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	202,516	222,084
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	35,198,369	35,198,369
10	<i>Të tjera të pagueshme (Parapagime)</i>	5,787,320	6,196,820
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		
▶	Të ardhura të shtyra		
▶	Provizione		
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera	43,160,120	48,793,080
▶	Detyrime afatgjata:	3,741,230,101	3,741,230,101
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	3,741,230,101	3,741,230,101
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
8	<i>Të tjera të pagueshme</i>		
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		
▶	Të ardhura të shtyra		
▶	Provizione:		40,000,000
1	<i>Provizione për pensionet</i>		
2	<i>Provizione të tjera</i>		40,000,000
▶	Detyrime tatimore të shtyra		
	Totali i Detyrimeve afatgjata	3,741,230,101	3,781,230,101
	DETYRIMET TOTALE	3,784,390,221	3,830,023,181
▶	Kapitali dhe Rezervat		
▶	Kapitali i Nënshkruar	3,714,037,296	3,714,037,296
▶	Primi i lidhur me kapitalin		
▶	Rezerva rivlerësimi		
▶	Rezerva të tjera	40,000,000	
1	<i>Rezerva ligjore</i>		
2	<i>Rezerva statutore</i>		
3	<i>Rezerva të tjera</i>	40,000,000	
▶	Fitimi i pashpërndarë	(405,001,605)	(358,381,261)
▶	Fitim / Humbja e Vitit	(539,146,545)	(46,620,344)
	Totali i Kapitalit	2,809,889,146	3,309,035,691
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	6,594,279,367	7,139,058,872

"AEROPORTI NENE TEREZA" SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

❖ PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2015	2014
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	3,557,694	4,503,668
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	8,820,890	1,166,406
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	829,375	546,282
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	829,375	546,282
	2 Të tjera shpenzime		
▶	Shpenzime të personelit	8,659,995	7,896,036
	1 Paga dhe shpërblime	7,566,685	6,898,108
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	1,093,310	997,928
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	638,763	644,759
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	20,290,801	2,408,916
▶	Të ardhura të tjera	103,230	973,243
	1 Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
	2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
	3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)	103,230	973,243
▶	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	521,209,425	
▶	Shpenzime financiare		41,767,667
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)		
	2 Shpenzime të tjera financiare		41,767,667
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		
▶	Fitimi/Humbja para tatimit	(539,146,545)	(46,620,343)
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		
	2 Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë		
	3 Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve		
▶	Fitimi/Humbja e vitit	(539,146,545)	(46,620,343)
▶	Fitimi/Humbja për:		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2015	2014
▶	Fitimi/Humbja e vitit	(539,146,545)	(46,620,343)
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
	Humbje nga provizionimi i klienteve		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	(539,146,545)	(46,620,343)
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

**❖ PASOYRA E FLUKSIT MONETAR
(Metoda indirekte)**

	2015	2014
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>	(539,146,545)	(46,620,343)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	638,763	644,759
<i>Vlera e mbetur i aktiveve afatgjata materiale j perdorim</i>	15,758,641	
<i>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
<i>Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	521,561,056	42,195,519
<i>Rënie/(ritje) në inventarë</i>	35,518	8,386
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	(5,632,960)	485,225
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(6,785,527)	(3,286,454)
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	(6,771,034)	
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		(15,369)
<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
<i>Dividentë të arkëtuar</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(6,771,034)	(15,369)
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>Hua të arkëtuara</i>		
<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>		
<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>Pagesa e huave</i>		
<i>Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
<i>Interes i paguar</i>		
<i>Dividendë të paguar</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	0	0
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(13,556,561)	(3,301,823)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2015	30,344,073	33,645,896
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2015	16,787,512	30,344,073

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

❖ PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT

(b) Në një pasqyrë të pakonsoliduar

	Kapitali i nënshkruar	Fitimi i udhëzuar me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
► Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	3,714,037,296						(368,923,930)	10,542,669			3,355,656,035
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël											0
► Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014	3,714,037,296	0	0	0	0	0	(368,923,930)	10,542,669	0	0	3,355,656,035
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											0
Fitimi / Humbja e vitit								(46,620,343)			(46,620,343)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											0
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											0
Destinacioni fitimit							10,542,669	(10,542,669)			
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											0
Dividendë të paguar											0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											0
► Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	3,714,037,296	0	0	0	0	0	(358,381,261)	(46,620,343)	0	0	3,309,035,692
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël											0
► Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015	3,714,037,296	0	0	0	0	0	(358,381,261)	(46,620,343)	0	0	3,309,035,692
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											0
Fitimi / Humbja e vitit								(539,146,545)			(539,146,545)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											0
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											0
Destinacioni fitimit							(46,620,343)	46,620,343			
Nga provizionet						40,000,000					
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											0
Dividendë të paguar											0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											0
► Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	3,714,037,296	0	0	0	0	40,000,000	(405,001,604)	(539,146,545)	0	0	2,809,889,147

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

III.SHENIME PER DREJTIMIN E SHOQERISE

Shoqeria: “AEROPORTI NENE TEREZA “ SH.A. TIRANE

Periudha ushtrimore 01 Janar 2015 deri me 31 Dhjetor 2015

1) TE DHENA TE PERGJITHSHME TE SHOQERISE

Shoqeria “AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A, eshte krijuar me date 18/01/1999. Me date 15/02/1999, me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Nr. 20819, Shoqeria eshte rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar. Krijimi i kesaj shoqerie eshte bazuar ne ligjin Nr.7638 Dt.19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare”, Shoqeria ne baze te ketij ligji Seksioni III, Neni 94,95 eshte shnderuar dhe funksionon si Shoqeri Anonime. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi si dhe nga Statuti i saj.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga e Duresit, Nr 202, Tirane.

Ajo eshte regjistruar prane organeve tatimore te rrethit Tirane me NIPT J 61820023 S.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise “Aeroporti Nene Tereza” sha ne QKR eshte “**Sherbime Aeroportuale, perpunimi i avioneve, sherbimi i pasagjereve, bagazheve e mallrave**”, mendojme qe duhet te behet shtese objekti per qeradhenie ndertesash.

Veprimtaria e Shoqerise zhvillohet ne nje afat kohor te pa caktuar.

a) Kapitali dhe pronësia

Kapitali i Shoqerise ne momentin e krijimit te saj eshte 3.023.000.000 leke. Gjate gjithe periudhes qe nga krijimi i shoqerise se deri ne 31.12.2015 kapitali i shoqerise ka pesuar disa here ndryshime duke u zvogeluar dhe zmadhuar. Te gjitha ndryshimet ne kapitalin e shoqerise jane bere ne zbatim te legjislacionit ne fuqi sipas periudhes kur kane ndodhur dhe jane rregjistruar ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane dhe ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit. Ne dt 31.12.2015 Kapitali aksionar i Shoqerise eshte 3.714.037. 296 leke. Numri kontributeve ne aksione eshte 3 714 037. Vlera nominale e kontributit 1.000 leke. Aksioner i vetem i Shoqerise eshte Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise, Turizmit dhe Sipermarjes, Perqindja e pjesmarjes 100%.

b) Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i pershtaten i natyres se Shoqerise dhe realizimit te objektit të veprimtarisë së saj. Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise deri ne 31.12.2015 eshte z. Arban Tarifa. Gjate vitit 2015 nuk kane ndodhur ndryshime te Perfaqesuesi ligjor i Shoqerise. Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administrimi e ushtron funksionin e tij nen kontrollin e keshillit mbikqyres i cili organi vendimmarres i Shoqerise.

Anetaret e keshillit mbikqyres ne dt.31.12.2015 jane:

- Arjana Dyrmishi
- Albana Koçiu
- Xhiko Shehaj

Ndryshimet ne Administrimin e Shoqerise jane pasqyruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit, po keshtu edhe ndryshimet ne perberjen e Keshillit Mbikqyres. Nuk eshte pasqyruar ne QKR emerimi i eksperteve per auditimin e pasqyrave financiare per ushtrimin e mbyllur ne date

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

2) MBI KONTABILITETIN

A. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te Publikuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit dhe interpretimeve. Standartet janë zbatuar deri në nivelin e që ato janë përkthyer dhe adoptuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK).

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar ne parimin e kostos historike, si dhe ne raportin e eksperteve te vleresimit dhe te eksperteve kontabel te autorizuar te vitit 2008.

b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne Leke, e cila është monedhe funksionale për shoqërinë.

c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasoje e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët me poshtë:

B. Politikat kryesore Kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Ne përgatitjen e pasqyrave financiare te shoqërisë, transaksionet ne monedha te ndryshme krahasuar me monedhen funksionale te shoqërisë rregjistrohen me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Ne çdo date te pasqyres se pozicionit financiar, aktivet dhe detyrimet monetare qe jane ne monedhe te huaj konvertohen me kursin e kembimit te dates se Pasqyres se pozicionit financiar. Diferencat nga kembimi njihen ne fitim ose humbje ne periudhjen ne te cilin krijohen. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare qe jane njohur me kosto historike ne monedhe te huaj konvertohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj dhe qe jane paraqitur me vlere te drejte konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten qe eshte percaktuar vlere e drejte.

Kurset e Kembimit	31 Dhjetor 2015
Euro/Leke	137.28
Usd/Leke	125.79
Chf/Leke	126.74
Gbp/Leke	186.59

b) Instrumentet financiare

Instrumente financiarë jo-derivativë te Shoqërisë përfshijnë llogari të arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjate periudhave te raportimit shoqëria nuk ka investime ne letra me vlere. Instrumentet financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë

○ *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogarite rrjedhëse në banka.

○ *Kërkesa për arkëtim*

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar dhe për humbjet nga zhvlerësimet.

○ *Llogari te detyrimeve te pagueshme*

Llogaritë e detyrimeve te pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

○ *Hua dhe kredi*

Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe kreditë konkretisht huaja e marre nga banka gjermane KFW per rikonstrukcionin e aeroportit paraqitet me kosto historike e pandryshuar nga marrja e saj. Likuidimi i huas kryet nga shoqeria koncensionare “Tirana International Airport” shpk.

○ *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

○ *Te tjera*

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabiliteti për të ardhurat dhe shpenzimet financiare shpjegohet ne shënimet e meposhteme.

c) Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka). Ne vitin 2008 ato kane qene objekt rivleresimi.

Toka dhe ndertesa perfshijne pergjithesisht ambjentet e zyrave. E gjithë pasuria e paluajtshme, ndertesat dhe makinerite paraqiten ne kosto, te rivleresuar (sic pershkruhet ne paragrafin e meposhtem) minus amortizimin perkates dhe zhvleresimin, pervec per token, e cila pasqyrohet me koston e rivleresuar minus zhvleresimin. Kostot e aktiveve te ndertuara vete perfshijne kostot e materialeve, punes direkte, si dhe cdo kosto tjeter qe lidhet me sjelljen e ketyre aktiveve ne gjendje pune dhe kostot per cmontimin dhe levizjen e tyre dhe pergatitjen e vendit ne te cilin do te vendosen. Programet kompjuterike te blera qe jane te nevojshme per vendosjen ne funksion te ketyre aktiveve kapitalizohen si pjese te ketyre mjeteve.

Aktivet te cilat jane nxjerre jashte perdorimit kane qene te kontabilizuar me vleren e bazuar ne vleren e tyre neto ne daten e daljes jashte perdorimit.

Kostot e pjeseve te nderrimit per makinerite dhe pajisjet njihen me vleren e tyre kontabel nese eshte e mundur qe njesia ekonomike te perfitoje te ardhura ekonomike nga kjo pjese dhe keto te ardhura mund te maten ne menyre te besueshme. Kostot e mirembajtjes dhe riparimeve te perditshme te pasurive te paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen ne fitim e humbje kur ato ndodhin.

ii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi bazen e vleres se mbetur per aktivet afatgjata. Normat e perdorura jane per ndertesat 5% te vleres se mbetur dhe per pjesen tjeter te aktiveve te tjera 20% , 25% te vleres se mbetur.

Toka dhe Ndertimet ne Proces, si dhe parapagimet e furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do ti rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

d) Inventarët

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me koston mesatare te ponderuar te blerjeve qe nga drejtimi eshte cmuar si vlera neto e e realizueshme.

e) Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar ne ato raste kur ekzistojne kushte objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje (pas njohjes se tij fillestare) kane efekte negative ne flukset e ardhshme te parase qe parashikohet te burojne prej atij aktivi. Veshtiresite e konsiderueshme financiare te debitorit, propabiliteti qe debitori do te falimentoje apo nje riorganizim financiar, dhe pamundesia apo shkeljet ne pagesa konsiderohen si tregues qe nje llogari e arketueshme eshte e zhvleresuar.

Çrregjistrimi: Aktivet financiare se bashku me fondin rezerve te zhvleresimit çrregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore te aktivitet. Detyrimet financiare çrregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise perfundojne, skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

f) Përfitimet e punonjësve

i. Sigurime shoqërore te detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

g) Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve te kaluara dhe është e mundur qe një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do te jete e nevojshme për te rregulluar detyrimin dhe një vlerësim te besueshëm te vlerës se detyrimit qe mund te behet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme te mjeteve monetare te ardhme para tatimit qe reflekton vlerësimet aktuale te tregut për vlerën ne kohe te parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik te detyrimit. Provizionet paraqiten ne çdo date bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur qe rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike te përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese te ardhme.

h) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat maten me vlerën e drejte të shumës se marre ose për tu arkëtuar dhe përfaqëson vlerën e arketueshme për te mirat dhe shërbimet te siguruara gjate aktivitetit normal te biznesit.

i) Shpenzimet

Shoqeria njeh shpenzimet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me kryerjen e tyre ne daten e raportimit. Shpenzimet paraqiten ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyres se tyre çka kerkon gjykim te konsiderueshem nga drejtimi i shoqerise.

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metoden e interesit efektiv.

j) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin

“AEROPORTI NENE TEREZA” SH.A. Tirane

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2015

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, si edhe çfaredolloy rregullimi kontabel të tatimit për tu paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shoqeria për vitin 2015 ka rezultuar me humbje.

3) ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

